



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Drejtoria e Auditimit te Brendshëm

Nr 82 prot

Tiranë, më 14.02 2017

Lënda: Pasqyrat dhe relacioni vjetor 2016.

Drejtuar: MINISTRIA E FINANCAVE

Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm

TIRANE

Në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "Pë auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm Publik po ju dërgojmë zyrtarisht Raportin përmbledhës për vitin 2016 bashkë me pasqyrat sipas formatit të raportimit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

MINISTRI
Mirela KUMBARO-FURXHI



Konc. Aida Toqi

Mirat. Edmonda SHKJEZI

- I. Përmbledhje Ekzekutive**
- II. Baza Ligjore**
- III. Organizimi**
 - ✚ Misioni i auditimit të brendshëm
 - ✚ Organizimi i NjAB
- IV. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm**
 - ✚ Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese
 - ✚ Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve
 - ✚ Fushat me risk më të lartë dhe trajtimi i tyre
 - ✚ Gjetjet kryesore sipas sistemeve
 - ✚ Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm
 - ✚ C'ështjet e dërguara për investigim
- V. Rekomandimet**
 - ✚ Rekomandimet e propozuara
 - ✚ Përgjigjia dhe reagimet e menaxhimit
- VI. Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë**
- VII. Analiza e Kapaciteteve Audituese**
 - ✚ Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB
 - ✚ Kapacitetet audituese
 - ✚ Zhvillimi i aftësive dhe ngritja e nivelit profesional të audituesve
 - ✚ Analiza e kostos dhe shperndarja e burimeve
- VIII. Konkluzione**
 - ✚ Konkluzione mbi problematikën e punës audituese
 - ✚ Prioritetet për vitin e ardhshëm

I. Përmbledhje Ekzekutive

Raporti Vjetor mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, fokusohet në drejtimet e mëposhtme:

Së pari: Komunikon rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm publik dhe tregon qeverisjen dhe shërbimin publik në institucione.

Raporti përçon problemet më të rëndësishme të identifikuara dhe të trajtuara, tregon ecurinë drejt përmirësimeve të vazhdueshme dhe veprimeve korrigjuese, si dhe sfidat e përpjekjet e pandërprera, për të siguruar pajtueshmërinë me kuadrin legjislativ të parashikuar në aktivitetin ekonomik e financiar.

Së dyti: Ky raport paraqet përgjegjshmërinë e realizimit të programit të auditimit. Ai trajton menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës, si dhe shkallën e pajtueshmërisë me standartet profesionale të auditimit. Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, janë të pasqyruara në raportet e auditimit të dërguar në çdo institucion.

Raporti, përshkruan statusin, autoritetin, strukturën organizative dhe burimet e njësisë së auditimit, ai përveç procesin e planifikimit mbi bazë risku.

II. Baza Ligjore

Kuadri ligjor dhe procedural i auditimit të brendshëm përfaqësohet nga:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji Nr.9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” me ndryshimet

Ligji nr. 114, datë 22.10.2015, “Pë auditin e brendshëm në sektorin publik”

Manuali i Auditimit të Brendshëm Publik dhe Manualin Specifik të MK;

Karta e Auditimit të Brendshëm Publik”

Kuadri e Praktikave Profesionale Ndërkombëtare, i cili përmban Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikave Profesionale të publikuara nga IIA.

Ligji mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin publik;

III. Organizimi

• Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni I DAB është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë, garantimi i zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike dhe forcimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhe shtimin e vlerës së institucioneve publike në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave në fushën e kulturës e të trashëgimisë kulturore.

DAB e ka kryer veprimtarinë e saj në zbatim të ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” me ndryshime, shfuqizuar me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, “Pë auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe akteve të dala në zbatim të tij, të cilët përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikave profesionale të auditimit të brendshëm,

• **Organizimi i NjAB**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm funksionon si drejtori në varësi të Ministrit. DAB funksionon sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri me Urdhër nr. 66, datë 07.04.2016” Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MK” i ndryshuar me Urdhërin nr. 179, datë 28.12.2016 dhe përbëhet prej 4 punonjësish, 1 drejtor dhe 4 specialist. Organika e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2016 rezulton e paplotësuar në 1 pozicion. Të gjithë punonjësit e drejtorisë janë me arsim të lartë për shkenca ekonomike.

Struktura e miratuar është si vijon:

Drejtues	1
Specialist audit	4

• **Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese**

Në zbatim të kërkesave të nenit 7, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ndryshuar me Ligjin Nr.10318, datë 16.09.2010 shfuqizuar me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015“Pë auditin e brendshëm në sektorin publik“ dhe të Kapitullit III, të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, shfuqizuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, veprimtaria audituese është orientuar në vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:


- ❖ identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
- ❖ përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
- ❖ ruajtjen e asetëve;
- ❖ besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
- ❖ kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë;
- ❖ përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;
- ❖ duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;

Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm është bërë në zbatim të programit vjetor nr.5165, datë 14.10.2015 ”Plani vjetor dhe strategjik 2016-2020”, ku janë planifikuar 34 auditime, planifikuar këtë numer, pasi menduam se do plotësohej struktura me një specialist audit, e cila është raportuar dhe në raportin e planit strategjik 2016-2020.

Planifikimi dhe realizimi i programit të auditimit për vitin 2016, paraqitet:

Nr.	Llojet e auditimit	Të planifikuara	Të realizuara	Realizimi në %
1	Të kombinuara(të plota)	15	15	100
2	Të përputhshmërisë	4	4	100
3	Ndjekja dhe zbatimi i	15	15	100

Planifikimi dhe realizimin e planit vjetor për vitin 2016 e paraqesim grafikisht paraqitet:




Megjithëse struktura është e paplotësuar me një specialist audit, plani është realizuar në masën 100%.

Nga 34 auditime të planifikuara për vitin 2016 janë realizuar 34 auditime, paraqitet në nivel 100%. Në 2 subjekte, misioni i auditimit është në proces, ka përfunduar puna në terren, është dërguar projekt raporti në njësinë e audituar, por nuk kanë përfunduar fazat e tjera dhe gjetjet e tyre nuk i kemi raportuar në pasqyrat përkatëse.

Në tabelat e mësipërme nuk janë përfshirë procedurat për mbylljen e 6 misioneve të auditimeve të mbartura nga viti 2015 të cilat kanë përfunduar në vitin 2016. Nga këto 3 auditime me bazë sistemi dhe 3 auditime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve.

Sikurse paraqitet grafikisht në vijim, realizimi i auditimeve të plota në nivel vjetor ndaj planifikimit vjetor si dhe krahasuar me vitet e mëparshme, tregon se është ruajtur stabilitet i qëndrueshëm në gjithë periudhat e vitit

Nr.	Llojet e auditimit	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
1	Të plota	13	14	15
2	Të pjesshme	22	15	19
	Gjithsej	35	29	34



Nga përlllogaritjet e ngarkesës për cdo auditim, kanë rezultuar mesatarisht për rreth 8 objekte të audituara mbi bazë sistemi. Drejtuesi i Drejtorisë, ka realizuar edhe punën e auditit.

Burimet e auditimit janë menaxhuar me eficiencë dhe në funksion të realizimit të planit vjetor duke u kujdesur për kostot e auditimit. Për realizimin e planit vjetor në grupet e auditimit janë përfshirë dhe specialistë të drejtorive të përmbajtjes në MK, sipas objektit të auditimit dhe fushës së veprimit.

Fushat me risk më të lartë dhe trajtimi i tyre

Planet Strategjike dhe Vjetore të Auditimit të Brendshëm janë përgatitur mbi bazën e riskut duke identifikuar dhe vlerësuar, risqet kryesore për veprimtarinë e institucioneve. Vlerësimi i riskut është bërë sipas problematikave të paraqitura nga titullaret e institucioneve në takimet e zhvilluar, analiza e raporteve vjetore, raportet e auditimeve të mëparshme dhe në disa raste është mbështetur mbi strategjinë e riskut të hartuar nga institucionet, pasi në disa institucione është hartuar plani strategjik I menaxhimit të riskut I cili do të shërbente si bazë për vlerësimin e tij.

Nga analiza e raporteve vjetore individuale si dhe nga intervistat e realizuara, rezulton se përcaktimi i nivelit të riskut, është bërë duke marrë në konsideratë faktorët e riskut, të cilët në mënyrë të përmbledhur do të përgjithësoheshin në kategoritë e mëposhtme:

- ❖ Sasia dhe përdorimi i burimeve në dispozicion të institucionit të audituar;
- ❖ Zbatimi i ligjshmërisë, politikave, procedurave, rregulloreve e planeve;
- ❖ Arritja e objektivave dhe rezultateve të pritshme;

- ❖ Ruajtja dhe miradministrimi i aseteve pronë publike;
- ❖ Kërkesat e raportimit financiar;
- ❖ Mjedisi i kontrollit;
- ❖ Shkalla e ndryshimeve organizative dhe në drejtim;
- ❖ Mbulimi i pamjaftueshëm me auditime në të kaluarën

Bazuar në faktorët e përmendur më sipër, vlerësojnë me risk më të lartë fushat në vijim:

- ❖ Sistemet e menaxhimit financiar. Pjesa më e madhe e të audituarve gjykojnë se pikërisht menaxhimi financiar është fusha ku risku është më i pranishëm. Po t'i referohemi analizës në seksionin “Gjetjet më të rëndësishme” të këtij raporti, janë pikërisht fushat e: prokurimeve publike, pagave, transaksioneve financiare, mbledhjes së të ardhurave dhe taksat, në të cilat janë zbuluar dhe shkeljet më të rëndësishme. Aplikimi i standarteve të reja është me risk.
- ❖ Institucionet që qarkullojnë shuma të konsiderueshme të fondeve publike, të cilat sigurohen nga një numër i madh burimesh financimi, ku përfshihen dhe të ardhurat.
- ❖ Investimet për ndërtimet dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, ku përfshihet jo vetëm zbatueshmëria e kuadrit ligjor, por edhe shkalla e cilësia e implementimit të kontratave. Këto fusha, shfaqen jo vetëm me risk të lartë financiar, por dhe operacional, që ka të bëjë me cilësinë e punimeve, pagesat jo në konformitet me gjëndjen aktuale të punimeve, mbikqyrjen dhe marrjen në dorëzim të objekteve dhe garancinë e standartit të punimeve.

Duke u bazuar në përcaktimin e fushave me risk më të lartë, sa më sipër, struktura audituese ka vendosur dhe prioritetet e saj. Kështu, në subjektet apo fushat me risk më të lartë, janë angazhuar të gjitha burimet e auditimit me kohë të gjatë auditimi, që do të thotë që në këto auditime janë përfshirë staf më nivel të lartë profesional dhe është siguruar kohë e mjaftueshme për vlerësimin e subjekteve. Në auditime me risk, ka marrë pjesë dhe drejtuesi i DAB.

Gjetjet e kryesore sipas sistemeve:

Gjate procesit të auditimit të brendshëm, menaxhimi është informuar mbi gjetjet e auditimit. Raportimi i gjetjeve të punës tek menaxhimi dhe lënia e rekomandimeve për të përmirësuar funksionimin e tyre, është një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të auditimit të brendshëm.

Nga institucionet ka patur reagime pozitive në lidhje me zbatimin e rekomandimeve. Me dërgimin e raportit final në cdo institucion, kemi informuar titullarin mbi përfundimin e cdo misioni auditues

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, për vitin 2016, janë dhënë gjithsej 69 rekomandime nga të cila 26 rekomandime ose në masën 38% të tyre janë realizuar dhe 42 rekomandime ose në masën 62% e tyre është në proces realizimi, 1

rekomandim i cili I përket rekomandimeve për arkëtim nuk është pranuar nga menaxhimi. Rekomandimet të ndara sipas prioritetit i paraqesim si vijon:


- ❖ Për përmirësimin e sistemit 12 rekomandime
- ❖ Për përmirësimin e kuadrit ligjor 5 rekomandime
- ❖ Të karakterit organizativ 42 rekomandime
- ❖ Rekomandime për arkëtim 2 rekomandime
- ❖ Rekomandime të tjera 8 rekomandime

Rekomandimet të ndara sipas sisteme i paraqesim më poshtë:

- ❖ Sistemin i administrimit të pronës, pasurisë 13.
- ❖ Sistemin i prokurimit, blerjeve dhe investimeve 5.
- ❖ Sistemin i pagesave, shpërblime... 8.
- ❖ Sistemin të tjera 41
- ❖ Sistemet e privatizimit, shitjes dhe qiradhënies 2.

Grafikisht paraqiten :

Sistemin i administrimit të pronës, pasurisë	Sistemin i prokurimit, blerjeve dhe investimeve	Sistemin i pagesave, shpërblime	Sistemet e privatizimit, shitjes dhe qiradhënies	Sistemin të tjera
13	5	8	2	41



Për vitin 2014 janë adresuar gjithsej 91 rekomandime, për vitin 2015 janë adresuar 47 rekomandime dhe për vitin 2016 janë adresuar 66 rekomandime.


Gjetjet e auditimit në vlerën 606 mijë lekë i përkasin: parregullsive, menaxhimit pa efektivitet të fondeve, përvetësime të pa drejta të parave publike, etj, sipas të cilave janë adresuar rekomandimet e auditimit. Te ndara sipas sistemeve/fushave, këto gjetje rezultojnë përkatesisht si më poshtë:

- ❖ Në sistemin e pagave dhe pagesave, në shumën 388 mijë lekë, që përbën vlerën e dëmit ekonomik.
- ❖ Në sistemin e administrimit të pronës e cila i përkët të ardhurave të munguar nga shfrytëzimi i monumenteve në vlerën 218 mijë lekë.

Ecuria e gjetjeve në 3 vitet e fundit në nivel vjetor paraqitet si vijon (në mijë lekë):

Nr.	Vlera e gjetjeve	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
1	Sistemi i Pagesave	7923	1046	388
2	Administrimi I pronës			218
	Gjithsej	7923	1046	606

Në mënyrë grafike i paraqesim si mëposhtë:



Vlera e gjetjeve me dëm ekonomik, në krahasim me vitin 2014-2015, janë ulur, si rrjedhojë e rritjes së nivelit të punës menaxhuese, por edhe lënies së rekomandimeve efikase dhe zbatimit të tyre

Vlerësimi i sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

Raportimi i brendshëm efektiv për drejtuesin është një bazë e mirë për monitorimin dhe zgjerimin e kontrolleve menaxheriale për të përmirësuar sistemet.

Është përgjegjësi e drejtuesit krijimi i një sistemi të mirëfilltë efikas kontrolli i brendshëm. Për të arritur këtë, nevojitet strukturë organizative adekuate të cilat përcaktojnë qartë linjat e autoritetit, raportimit dhe përgjegjësi nga secili nivel .

Dobësit menaxheriale, financiare dhe të zbatimit të kontrollit të brendshëm të trajtuara në raportet individuale të auditimit, tregojnë se koncepti i MFKB ende nuk është kuptuar sa duhet nga institucionet e varësisë. Dobësitë e sistemi të MFKB tregojnë mangësit e hasura si në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit, delegim dhe ndarje të detyrave, planifikim dhe realizim të të ardhurave, menaxhim të personelit, menaxhim të pasurisë dhe detyrimeve, mangësit në raportimin dhe konsolidimin e PBA.

Shumica e institucioneve nuk kanë udhëzime të brendshme apo procedura operative të detajuara që mbulojnë aktivitetet e përditshme të ndërlidhura me MFKB.

Raportimet e dobëta menaxheriale bëjnë që vendimmarrja dhe reagimi për përmirësimet e nevojshme të jetë i vonuar.

Sfidë e institucioneve vazhdon të jetë menaxhimi i riskut, ky një komponent kyç i MFKB. Institucionet, në përgjithësi, nuk kanë procedura të dokumentuara në menaxhimin e riskut, nuk identifikojnë, analizojnë, vlerësojnë dhe as nuk ndërmarrin veprime për të menaxhuar riskun në arritjen e objektivave të tyre.

V. REKOMANDIMET

Rekomandimet e adresuara nga DAB kanë për synim përmirësimin më të mirë të menaxhimit menaxhimit financiar dhe qeverisjes. Shkalla e implementimit të rekomandimeve të kaluara, pra të lëna nga auditimet e mëparshme, në nivel institucional akoma nuk është e kënaqshme, përkundër faktit se ka përmirësime me kalimin e viteve. Kjo ka ndikuar që një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të përsëriten edhe në auditimet e ushtruara në vitin 2016. Në implementimin e dobët të rekomandimeve ka ndikuar mungesa e veprimeve të duhura nga menaxherët e institucioneve.

Rekomandimet e dhëna bazuar në natyrën e gjetjeve janë për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ndreqjen e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve dhe shkeljeve, ruajtjen e aseteve publike, çdëmtimin e vlerave për dëme të shkaktuara nga persona përgjegjës ose të përfituara padrejtësisht.

Rekomandimet më të rëndësishme që ende nuk janë realizuar janë:

- ❖ Përfundimi i procesit të hartimit dhe miratimit të statuteve dhe Rregulloreve të Brendshme për pjesën më të madhe të institucioneve, ku të gjejnë pasqyrim detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr.10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” I ndryshuar Kodi Etikës.
- ❖ Të hartohet rregjistri i riskut dhe ai duhet të jetë sipas përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve” të “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- ❖ Konstatimi i fushave me dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm, të

cilat shfaqen me mangësi në kuadrin rregullator e procedural.

- ❖ Menaxhimi i burimeve njerëzore. Lëvizja e shpeshtë e stafit dhe niveli i ulët profesional i punonjësve, ka ndikuar negativisht në arritjen e objektivave dhe cilësinë e punës.
- ❖ Planifikim më i saktë I buxhetit, për shpenzimet operative dhe monitorimi i realizimit të tyre, pasi në disa institucione, rezultojnë detyrime në fund të vitit, ndaj furnitorëve për blerje dhe shërbime, që kanë tejkaluar fondet e vitit ushtrimor.
- ❖ Mungesa e miratimit të tarifave sipas propozimeve të bëra nga institucionet e artit dhe të trashëgimisë. Për realizimin e tyre është kërkuar bashkëpunim ndërmjet institucioneve dhe MK.
- ❖ Arkivimi i dosjeve të prokurimeve me vlera të larta dhe arkivimi I dosjeve të projekteve artistike.
- ❖ Në disa raste mungesa e përcaktimit dhe miratimit të fondit limit në zbatim të Ligjit “Për prokurimin publik” dhe akteve nënligjore
- ❖ Mungesa e zbatimit të plotë të Gjurmës së Auditit.
- ❖ Emërimi i nëpunësit zbatues si nëpunës me varësi direkte nga titullari, përgjegjës për menaxhimin e aktiveve.

Pjesë e punës tonë gjatë kryerjes së auditimeve, është edhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitet paraprake. Gjatë auditimeve të kryera në 15 institucione të varësisë ne kemi analizuar mënyrën se si janë adresuar rekomandimet. Përveç rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2016 ne kemi analizuar edhe implementimin e rekomandimeve të lëna në vitin 2015. Nga kjo analizë del se disa nga rekomandimet e dhëna në vitin 2016 edhe pse ishin përsëritur në raportin e vitit 2015, ato ende nuk janë adresuar dhe realizuar.

Një analizë e tillë ka qenë subjekt i punës tonë dhe në të gjitha auditimet individuale ku janë dhënë rekomandime.

Implementimi i rekomandimeve vazhdon të jetë sfidë e vështirë për organizatat. Mos adresimi i rekomandimeve të dhëna ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme në kontrollin e brendshëm dhe ka bërë që disa nga rekomandimet që përsëriten. Në cdo auditim në të cilat është konstatuar moszbatim i rekomandimeve është rekomanduar:

- ❖ Institucioni të bëjë identifikimin dhe sqarimin e rrethanave të cilat kanë penguar adresimin e rekomandimeve të mëparshme si dhe ndërrmarjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin efektiv dhe me kohë të tyre;
- ❖ Të shqyrtojë arsyet e mos adresimit të rekomandimeve të mëhershme për të gjetur shkaqet që kanë shkaktuar përsëritjen e tyre;

Në asnjë rast nuk janë paraqitur dyshime për vepra penale për abuzime, shpërdorime pranë organeve ligjore.

Përgjigjia dhe reagimet e menaxhimit

Sikurse përcaktohet dhe në misionin e auditimit të brendshëm, objektivi i tij është *dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit dhe shtimin e vlerës së subjektit* nga titullaret e institucionit. Arritja e këtij objektivi, përcaktohet në një masë të madhe nga cilësia dhe zbatueshmëria e rekomandimeve, por tregon gjithashtu përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxhimit të subjekteve publike mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatim i rekomandimeve. Është e njohur, që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve, rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër, përgjegjësia e auditimit të brendshëm, nuk kufizohet vetëm në dhënien, por edhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, pasi dhe rezultatet e punës audituese, varen në një masë të madhe nga ky faktor.

Rezulton se për vitin 2016, nga 15 institucione të audituara janë konfirmuar zbatimi i rekomandimeve për të 15 institucionet. Ky tregues, përbën dhe vlerësimin që i bëhet punës audituese.

IV. Analiza e kapaciteteve të strukturave audituese

■ Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB.

Për vitin 2015 DAB ka funksionuar me 4 punonjës.

NJAD është e organizuar në Drejtori më vete me varësi funksionale nga Titullari i Ministrisë ndërsa varësia administrative (lidhur edhe me statusin e nëpunësit civil, etj) është nga Sekretari i Përgjithshëm.

Arsimi bazë për punonjësit e auditimit është profesioni ekonomist dhe të gjithë punonjësit janë të certifikuar sipas kërkesave ligjore.

Kanë përmbushur detyrimin për kryerjen e 40 orëve trajnim të përditësuar në fushën e auditimit sipas njoftimeve të NJQH/AB dhe e kanë përfunduar me sukses vlerësimin e njohurive. Njohuritë e marra gjatë trajnimeve i ka vënë në zbatim dhe kanë patur ndikim të dobishëm në performancë.

Fuqizimi i strukturës dhe me një audit, besoj është dhe një zgjidhje më e mirë për rritjen e cilësisë së punës.

Ndonëse ndërmerren iniciativa të rëndësishme për të realizuar funksionimin normal të institucioneve, veprimtaria e tyre parashikohet të jetë e shoqëruar edhe me risqe të fushës gjatë aktivitetit. Në përmbushjen e objektivave dhe programit të saj, struktura e AB ka parë me interes dhe njohjen e risqeve.

■ Konkluzione mbi problematikën e punës audituese

Kapacitetet menaxhuese të institucioneve kanë tendencë rritje dhe përmirësimi të vazhdueshëm në shumë fusha të veprimtarisë së tyre. Edhe përmbushja e kërkesave ligjore për raportim financiar është evidente. Me gjithë të arriturat, institucionet vazhdojnë të

ballafaqohen me sfida nga më të ndryshmet. Buxheti i limituar në raport me nevojat kanë pasur efektin e vet. Një analizë më e thellë e nevojave specifike për secilin institucion është e nevojshme para se të përcaktohen kufijtë buxhetor.

Marrja e angazhimeve përtej fondeve në dispozicion e në disa raste mungesa profesionale në vlerësimin e nevojave buxhetore nga vet ato, vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarisë. Institucionet gjithashtu vazhdojnë të sfidohen dhe në menaxhimin e të hyrave dhe të detyrimeve, si dhe me raportimin e brendshëm. Ngecjet në adresimin e rekomandimeve, kanë bërë që parregullsitë të përsëriten vit pas viti. Aktivitetet menaxheriale duhet të kenë fokus të veçantë monitorimin dhe realizimin e projekteve me kohë dhe përmbushjen e planeve dhe objektivave. Në disa raste kontrollet e brendshme nuk ishin efikase në administrimin dhe menaxhimin e pasurisë. Institucionet nuk kishin evidenca të plota për aktivet që administrojnë. Kjo kishte reflektim negativ edhe në raportimin financiar dhe me ndikim në opinionet e auditimit.

Kontrolli i brendshëm dhe delegimi i detyrave dhe përgjegjësive është një nga sfidat kryesore me të cilat po përballen disa institucione. Ndikim në këtë ka patur numri i vogël i personelit që kanë këto institucione.

Fuqizimi i strukturës me një audit, është zgjidhje më e mirë për rritjen e cilësisë së punës.

Si një nga tre “shtyllat” e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, funksioni i auditimit zhvillohet dhe përmirësohet në vazhdimësi, në mënyrë që të fitojë rolin e tij të ri modern, si vlerësues dhe këshillues për sistemet dhe të sigurojë arritjen e objektivit të tij strategjik, gjithnjë në pajtueshmëri me standardet dhe praktikatat më të mira.

Prioritetet për vitin e ardhshëm

- ❖ Zhvillimi i kapacitetit institucional të DAB;
- ❖ Përmirësimi i kapaciteteve audituese dhe cilësisë së auditimit;
- ❖ Rritja e numrit dhe cilësisë së auditimit të performancës;
- ❖ Përgatitja dhe konsolidimi i auditimeve të teknologjisë së informacionit;
- ❖ Rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit në procesin e auditimit;
- ❖ Forcimi i rolit të DAB-së kundër korrupsionit
- ❖ Zhvillimi i bashkëpunimit me aktorë të tjerë përkatës brenda vendit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Drejtor DAB

Edmonda SHKJEZI

**NIVELLI I ORGANIZIMIT TE NJESISE SE AUDITIMIT TE BRENDSHEM DREJTORI
VARËSIA E NJËSISË SË AUDITIMIT BRENDSHEM MINISTRI
NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË 5**

Të dhëna për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm për vitin 2016

NR	EMËR MBRIEMËR	Pozicioni	Arsimi Bazë	Niveli i Diplomës	Eksperienca e Punës		Zhvillimi Profesional			Trajtime në fushën e AB	Publikime në fushën e AB
					Vitet e Punës Gjithsej	Vitet e Punës në AB	Certifikimi				
							I pa certifikuar	Në proces certifikimi	I certifikuar r në vitin		
a.	b.	1	2	3	4	5	6.1	6.2	6.3	7.1	7.2
1	Edmonda SHKJEZI	Drejtor	Universiteti Tiranë/Ekonomist Finance	Mast Shkenc	40	13			po	M. e Finances	Jo
2	Tefta REZHDA	Specialist	Universiteti Tiranës/Ek.per industrin	Mast Shkenc	39	13			po	M. e Finances	Jo
3	Mimoza BALLA	Specialist	Universiteti Tiranë/Ekonomist Finance	Mast Shkenc	33	7			po	M. e Finances	Jo
4	Aida KADISI	Specialist	Fakulteti I Bujqësisë/Ekonomist, Agrobiznes	Mast Shkenc	17	15			po	M. e Finances	Jo
5											

Drejtuesi i NJAB

Edmonda SHKJEZI



19	4	0	0	0	15	0	0	15	4
----	---	---	---	---	----	---	---	----	---

Ps: Ne numrin rendor 14 janë pasqyruar auditimet e kryera ne 4 institucionet e varesise ku janë zhvilluar misione auditimi të perputhshmërisë. Ne pasqyrën e mësipërme nuk janë pasqyruar auditimet në 15 institucione nga DAB janë ndjekur zbatimimi I rekomandimeve për të cilat është hartuar memorandumi per titullarin e njesisë. Verifikimimet janë kryer në institucionet si: Aparati I Ministrisë së MK, Agjencia e Sherbimit Arkeologjik , Biblioteka Kombëtare, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Vlorë, Muzeu Kombëtar i Fotografisë, Shkoder, Muzeu I Pavarësisë, Vlorë, Cirku Kombëtar, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Qendra e Veprimtarive Folklorike, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Qendra Kombëtare e Muzeve, Berat, Qendra e Realizimit të Veprave të Artit, Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar Eksperimental, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Korçë

Drejtuesi i DAB

Edmonda SHKJEZI



GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMIT												
16	Muzeu Historik Kombetar											
Totali		0	388	0	0	218	0	0	0	0	0	0
												606

Drejtuessi i DAB

Edmonda SHKJEZI



DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E KULTURËS
Përmblendhëse e parregullsisve të identifikuarra sipas sistemeve për vitin 2016

Pasqyra 4

Në numër

Nr.	Subjekti i Audituar	GJELJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE										Gjithsej
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig.shoq, sig.shendetesore, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve, urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, suvencioneve	Të tjera	
a.	1	2.1	2.2	2.3	2.4	2.5	2.6	2.7	2.8	2.9	2.1	3
1	DRKK Durres										1	1
2	DRKK Beral										2	2
3	Muzeu Arit Mesjetar Korce											
4	Zyra e Adm Koor. Apoloni	1	1			3	1				7	13
5	Zyra e Adm Koor. Bylis	1	2			2					2	7
6	Qendra Ndwrkomb kultures , Arbnori		4			3					4	11
7	Teatri Komb. I Operas, Baleit	1				3					4	9
8	Arkivi Qendror I Filmit					2					2	4
9	DRKK, Shkoder											
10	Qendra Komb Kinematografike											
11	Galeria Kombetare e Arteve	1					1				7	9
12	IMK "Gani Strazimir"										4	4
13	DRKK-Gjrokkaster	1	1								4	6
14	Cirku I Tiranes, QKIPK QRVA TKE- Kujtim Spahivogli											0
15	Zyra Shqiptare per Drejten e Autorit										3	3
16	Muzeu Historik Kombetar											0
	Totali	5	8	0	0	13	2	0	0	0	41	69

Drejtuessi i DAB Edmonda SHKJEZI



Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2016

Në numër

Nr	Rekomandimet e dhëna sipas prioritetit	Subjekte të Audituar	Statusi i Rek. të dhëna në vitin e mëparshëm	STATUSI I REKOMANDIMEVE					Arsyeja e mos zbatimit
				Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar nga menaxhimi	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi		
1	Rekomandime të përmirësimit e sistemeve Në zbatim të kërkesave të pikave 1 dhe 2 të nenit 3, neni 8, 18, 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të Kontrollit të Brendshëm në njësitë publike” institucioni: Të hartojë planin strategjik afatmesëm dhe vjetor, ku të përcaktohen objektivat kryesore, si dhe të hartohet plani i veprimeve për arritjen e objektivave. Të hartojë raportin vjetor të MFK në bazë të vetëvlersimeve dhe ta depozitoj te titullari i njësisë publike deklaruar dhe raportim për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit, brenda afateve. Të hartojë strategjinë e menaxhimit të riskut.								
2	Në zbatim të pikës 80, kreu IV “Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve” nëpunësi zbatues të bëjë kontroll periodik mbi përcaktimin e gjendjes së letrave me vlerë, biletave me anë të inventarizimit fizik çdo muaj, dokumentuar me procesverbale të nënshkruara nga personi përgjegjës. Paisjen me kasafortë për ruajtjen e letrave me vlerë - biletat e institucionit.	APOLONIA	3	1	1		1		Faza e hartimit
3	Në zbatim të V.K.M nr.1242, datë 16.12.2009 “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxirret në ankand...” i ndryshuar. Të merren masa për përfundimin e procedurës të ankandit të dy automjeteve.	DRRK, Berat	3	1	1		1		Me buxhetin 2017

<p>“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Titullari i Institucionit, të vendosë dhe të realizojë një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim përdorimin e fondëve publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.</p> <p>- Të hartoi strategjinë e menaxhimit të riskut sic kërkohet në nenin 21, të ligjit të mësipërm.</p> <p>- Institucioni të marrë masa për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit në zbatim të nenit 12, 16 dhe 23 të ligjit për MFK, gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundimin e tyre, që synon të ripërkthejë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimtarjen lidhur me to.</p>	<p>DRKK, SHKODER</p>						<p>Në fazën e hartimit</p>
<p>5 Në zbatim të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Institucioni të marrë masa të menjëhershme për administrimin dhe dokumentimin e aktiveve, konkretisht shitjen e biletave dhe arkëtimin e të hollave nga to, trajtuar në gjërë në material si dhe plotësimin e strukturës me pozicionet e bilatashitësit.</p>							
<p>6 Në zbatim të neni 7, të Ligjit 9048, “Për trashëgiminë kulturore”, me ndryshime, institucioni të marrë masa për përfundimin e verifikimit dhe regjistrimin pranë QKIPK të monumenteve të tjera në juridiksionin e DRKK-Shkodër</p>							<p>Në bashkëpunim me QKIPK</p>
<p>7 Titullari i DRKK, Shkodër të hartojë procedurat përkatëse për tu siguruar se rekomandimet e lëna nga auditimet e kryera të zbatohen plotësisht.</p>							
<p>8 Në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, Kreu VII, neni 60 dhe VKM nr.28, datë14.01.2015 “Për ngarkimin e MB për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër e për llogari të Kryeministrit, ministrit dhe institucioneve të varësishme”, procedurat prokurimit të shërbimeve roje, të kryhen nga MB.</p>	<p>DRKK, Gjirokastrë</p>	<p>3</p>	<p>1</p>	<p>1</p>		<p>1</p>	<p>Per vitin 2017</p>
<p>9 Të rishikohen strukturat me të cilën operon DRKK-Gjirokastrë për pozicionet e cituara në pikën 4 të projektraportit, të bëhen propozime nga titullari i institucionit dhe të miratohen në MK</p>			<p>1</p>	<p>1</p>		<p>1</p>	<p>Nga institucioni janë përgatitur procedurat dhe janë dërguar në mk për miratim</p>

<p>10</p> <p>prokurimin publik" i ndryshuar dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, neni 60 dhe VKM nr.28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e MB për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër e për llogari të Kryeministrit, ministrit dhe institucioneve të varësisë", procedurat prokurimit të shërbimit me roje, të kryhen nga MB.</p>	<p>Galeria Kombetare e Arteve</p>	<p>15</p>	<p>1</p>	<p>1</p>	<p>1</p>	<p>1</p>	<p>Nga institucioni janë pregatitur procedurat dhe janë dërguar në MK për miratim</p>
<p>11</p> <p>Në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nr.1665/1, datë 05.03.2014 «Për cakimin e tarifave përmbartimore për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat» Kreu IX «Tarifat dhe llogaritja e tyre bazuar në vlerën e padisë», pika 3/a, të llogaritiet dhe të propozohet në buxhetin e 6-mujorit të II-të të vitit 2016, fond në art.602, për pagesën e tarifës që GKA të marrë paratë e qirasë, nga detyrimi i palës së paditur firma «Pierre Cardin» shpk, në shumën 7.938.892 lekë (me kamatvonesë).</p>			<p>1</p>	<p>1</p>		<p>1</p>	<p>Me celjen e buxhetit 2017</p>
<p>12</p> <p>Në zbatim të kërkesave të pikave 1 dhe 2 të nenit 3, neni 8, 18, 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të Kontrollit të Brendshëm në njësitë publike". - Të hartojë planin strategjik afatmesëm dhe vjetor, ku të përcaktohen objektivat kryesore, si dhe të hartohet plani i veprimeve për arritjen e objektivave. Të hartojë raportin vjetor të MFK, në bazë të vetëvlerësimeve dhe ta depozitoj te titullari i njësisë publike për cilësinë dhe gjëndjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit, brenda afateve. Të hartojë strategjinë e menaxhimit të riskut.</p>	<p>ZSHDA</p>	<p>16</p>	<p>1</p>	<p>1</p>	<p>1</p>		
<p>SHUMA 1</p>		<p>37</p>	<p>12</p>	<p>12</p>	<p>2</p>	<p>10</p>	

Rekomandime të përmirësimit e kuadrit ligjor

<p>13</p> <p>Në zbatim të Ligjit nr.90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Ligjit nr. nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” Kreu III “Institucionet publike qëndrore të Artit dhe të Kulturës” neni 7, pika 2, VKM nr.844, datë 27.09.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës” nga drejtorja e institucionit në bashkëpunim me DKEPK dhe Drejtorinë Juridike & të Marrveshjeve në MK, të propozohet statuti ku të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrat sipas strukturës me të cilën operon GKA dhe të miratohen në MK.</p>	<p>Galeria Kombëtare e Arteve</p>			1	1	1	<p>Janë hartuar procedurat nga institucioni, dhe janë derguar per miratim në MK</p>
